

VENDIM

Nr.297, date 8.5.2003

PER MIRATIMIN E PROCEDURES SE DHENIES ME KONCESION SI PROPOZIM I PAKERKUAR, SIPAS PROJEKTIT TE SHOQERISE "LA PETROLIFERA ITALO RUMENA" SPA PER NDERTIMIN DHE SHFRYTEZIMIN E DEPOZITAVE BREGDETARE DHE TE INFRASTRUKTURES PORTUALE DETARE NE GJIRIN E VLORES

Ne mbështetje te nenit 100 te Kushtetutës dhe te neneve 7 e 9 te ligjit nr. 7973, date 26.7.1995 "Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat ne shërbimet publike dhe infrastrukture", i ndryshuar, me propozimin e Ministrit te Ekonomisë dhe te Ministrit te Industrisë dhe te Energjetikes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e procedurës se dhënies me koncesion, si propozim i pakerkuar, sipas projektit te shoqërisë "La Petrolifera Italo Rumena" s.p.a. për ndërtimin dhe shfrytëzimin e depozitave bregdetare te naftës e te nënprodukteve te saj dhe te infrastrukturës portuale detare ne Gjirin e Vlorës, ne zonën e miratuar si shesh ndërtimi me vendimin nr.9, date 19.1.2003 te Këshillit te Rregullimit te Territorit te Republikës se Shqipërisë.
 2. Miratimin e procedurave për negociimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes se koncesionit te formës "BOO", (Ndërtim-Pronësi-Shfrytëzim), për ndërtimin dhe shfrytëzimin e depozitave bregdetare te naftës dhe te nënprodukteve te saj, sipas specifikimeve te pikës 1 te këtij vendimi.
 3. Miratimin e procedurave për negociimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes se koncesionit te formës "BOT" , (Ndërtim-Shfrytëzim- Transferim), për ndërtimin dhe shfrytëzimin e infrastrukturës portuale detare, ne shërbim te depozitave bregdetare, sipas specifikimeve te pikës 1 te këtij vendimi.
 4. Organi shtetëror i autorizuar për negociimin dhe nënshkrimin e marrëveshjeve te koncesionit, qe parashikohet ne pikat 2 dhe 3 te këtij vendimi, te jene Ministria e Industrisë dhe e Energjetikes, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit, Ministria e Mjedisit, Ministria e Financave dhe Ministria e Rregullimit te Territorit dhe e Turizmit.
 5. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Ministria e Industrisë dhe e Energjetikes, Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit, Ministria e Mjedisit, Ministria e Financave dhe Ministria e Rregullimit te Territorit dhe e Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn ne fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano